



Dalës-Izlazna

Nr. V/11-52  
Br.

Data 03.04.2019  
Datum



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo- Republic of Kosova  
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq  
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- Direkcija za Zdravstvo i Socijalno Mirotvorno  
Department for Health and Sociale Welfare

Në mbështetje të ligjit të punës nr.03/L-212 neni 8, pika 1 dhe 2, ligjit të shëndetësië 04/L-125 dhe statutit të QKMF-së, Drejtoria e DSHMS, me datën 03 Prill 2019 shpallë:

## KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës me orar të plotë.

- Mjek/e i/e përgjithshëm/e-----2 pozita,
- Teknik/e i/e përgjithshëm/e-----1 pozitë,
- Teknik/e i/e dhëmbëve-----2 pozita,
- Teknik/e laborant/e mjekësor/e-----1 pozitë,
- Shtëpiak-----1 pozitë,

Vendi i punës: QKMF, QMF, AMF

### I- Mjek/e i/e përgjithshëm/e- dy pozita

Koeficienti: 7.20

Orari i punës: 40 orë në javë

Periudhë provuese 6 muaj

Kushtet profesionale:

- a) përgatitja superiore-Fakulteti i Mjekësisë, drejtimi i përgjithshëm,
- b) profesioni – Mjek/e (doktor i mjekësisë),
- c) të jetë i/e regjistruar dhe licencuar në MSH.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ofron shërbime me standard të lartë bazuar në mjekësinë e bazuar në dëshmi,
- ofron shërbime gjithpërfshirëse për individin/pacientin dhe familjen në të gjitha episodet e jetës në mbikqyrje të Mjekut Familjar,
- harton dhe zhvillon planin e trajtimit të sëmundjes dhe trajton pacientin si figurë qendrore nën mbikqyrje të Mjekut Familjar,
- përcakton diagnozë diferenciale dhe diagnozën e punës në përputhje me simptomatologjinë,
- përcjell sistematikisht rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe adoleshentëve,
- kujdeset për personat e moshuar dhe në nevojë,
- ofron kujdes për rastet urgjente dhe i referon rastet me kohë dhe në mënyrë adekuate,
- interpreton rezultatet e testeve të shpejta laboratorike,
- komunikon ose konsultohet me specialistë të MF sipas nevojës,
- referon pacientin te specialisti i MF dhe për kujdes spitalor,
- tregon kujdes të vazhdueshëm për pacientët me sëmundje kronike jo ngjitëse,
- bën kontrollin e sëmundjeve ngjitëse (hulumtimet epidemiologjike),
- promovimi shëndetësor dhe parandalimi i sëmundjeve si dhe shërbimet në komunitete(grupet vulnerable, vendet rurale, shkolla, komunitete),
- vepron në mënyre profesionale, duke respektuar rregulloret për KPSH dhe vepron në përputhje me të gjitha rregulloret, procedurat dhe politikat e MSH në fuqi,
- përcakton diagnozën përfundimtare dhe përshkruan terapinë,
- i nënshtrohet programit nacional të ZHVP-së,

- përkujdeset për konfidencialitetin e individit,
- përcjellë sëmundshmërinë nën mbikqyrje të MF,
- identifikon grupet e veçanta të rrezikut,
- merrë pjesë në grupet e rishqyrtimit kolegjial dhe sjellë vendime të përbashkëta për menaxhimin e sëmundjeve,
- ndihmon MF në zhvillimin e auditeve mjekësore në institucionin përkatës.
- merrë pjesë në takime, konferenca dhe tregojnë interesim në zhvillimin e strategjive për përmirësim të intervenimeve klinike dhe nivelit të lartë të kujdesit ndaj pacientit.

## II-Teknik/infermier-e i/e përgjithshëm/e- 1 pozitë

**Koeficienti: 4.80**

**Orari i punës: 40 orë në javë**

**Periudhë provuese 6 muaj**

Kushtet profesionale:

- Të ketë të kryer shkollën e mesme ose baqellor në drejtimin Infermieri e përgjithshme,
- të jetë Infermier/e i/e regjistruar dhe licencuar në MSH.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Praktikon në përputhje me kodin etik dhe zbaton procesin e kujdesit infermieror të dokumentuar,
- reagon në mënyrë efektive për të papriturat ose ndryshon situatën me shpejtësi,
- vlerëson, planifikon, zbaton dhe rivlerëson kujdesin infermieror të ofruar në përputhje, me moshën, gjendjen fizike, psikosociale, kulturore dhe shpirtërore të individit/pacientit dhe familjes, në pajtueshmëri me standardet e përcaktuara,
- menaxhon rastet dhe avokon për të drejtat e tyre, duke qenë burim dhe person kontakti për ta,
- komunikon në mënyrë efektive me individin/pacientin apo familjen dhe ofron kujdes të standardit të lartë dhe dokumenton punën e bërë,
- ofron promovim dhe edukim shëndetësor për individin/pacientin dhe familjen, me theks të veçantë në marrjen e përgjegjësisë për vetëkujdes konform moshës dhe nevojave të identifikuara,
- grumbullon dhe dokumenton të dhënat subjektive dhe objektive për individin/pacientin dhe rishqyrton informatat themelore të individit/pacientit duke u përqendruar në ambientin ku jeton,
- ofron shërbime për të parandaluar sëmundjen dhe për të avancuar dhe promovuar jetë të shëndoshë dhe të sigurtë lidhur me: shëndetin riprodhues dhe planifikimin familjar,
- ofron shërbimet e kujdesit: ante, peri dhe post natal, imunizimin dhe vaksinimin, zhvillimin e fëmijëve, kujdesin për adoleshentë dhe të rinjë dhe shëndetin oral prevenues,
- ofron shërbime infermiore duke përfshirë kujdesin shtëpiak për: nëna dhe fëmijë, sëmundje kronike jo- ngjitëse, shëndet mendorë dhe kujdesin terminal/paliativ.
- përgatitë dhomën e ekzaminimit me paisje dhe furnizime të nevojshme të kërkuara për vizitë, gjithashtu asiston gjatë ekzaminimit dhe procedurave të kërkuara,
- administron terapinë enterale dhe parenterale të përshkruara nga Mjeku Familjar me shkathtësi dhe përpikmëri,
- respekton masat aseptike gjatë marjes së mostrave laboratorike, përfshirë edhe kontrollën e kualitetit dhe mirëmbajtjen e të gjitha testeve të shpejta laboratorike, diagnostike dhe informon menjëherë rezultatet me vlera jo normale të testeve laboratorike të ordinuara nga Mjeku Familjar.
- përmban konfidencialitet të plotë për të gjitha qështjet që i përkasin individit, pacientit dhe familjes, veprimtarisë së KPSH-së përveç nëse është i/e autorizuar me shkrim nga menaxheri,
- mbështet dhe kontribuon në hulumtime të kujdesit shëndetësorë që ndërlidhen me dëshmitë për siguri dhe praktikën efektive,
- vepron në mënyrë profesionale dhe në përputhje me të gjitha rregulloret, procedurat dhe politikat e MSH-së në fuqi për KPSH,
- zbaton detyrat e deleguara nga menaxheri në pajtueshmëri me politikat shëndetësore në fuqi, gjithnjë duke ruajtur konfidencialitetin profesional,
- punon dhe bashkëpunon me profesionistët tjerë shëndetësor në KPSH, duke përdorur mekanizmin për monitorimin e rezultatit të kujdesit ndaj individit/pacientit dhe familjes,
- identifikon rëndësinë e kërkimit për të përmirësuar rezultatet e shëndetit për individin/pacientin,
- realizon veprimin e duhur dhe të sigurtë, deponon dhe administron paisjet, barnat dhe të gjitha informatat klinike në mënyrë të duhur dhe me një kosto efektive,

- merr pjesë në zhvillimin dhe përpilimin e udhëzimeve dhe protokoleve të shkruara, procedurave për shërbimet infermierore,
- zbaton protokolet e praktikave infermierore të bazuara në dëshmi, mbledh të dhëna në mënyrë sistematike dhe vlerëson të dhënat në aspektin fizik, socio-kulturor dhe mendor për shëndetin e individit/pacientit dhe familjes,
- merr pjesë në mbledhjet dhe aktivitetet e ekipit të Mjekësisë Familjare për të përmirësuar performancën e tij/saj dhe të institucionit,
- ka qëndrim pozitiv drejt ndryshimeve në përmirësimin e kujdesit dhe ngritjen e cilësisë përmes EVM,

### III-Teknik/e në Stomatologji- 2 pozitë

**Koeficienti: 4.80**

**Orari i punës: 40 orë në javë**

**Periudhë provuese 6 muaj**

Kushtet profesionale:

- a) përgatitja e mesme e mjekësisë- drejtimi i stomatologjisë
- b) profesioni – Teknik në Stomatologji

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- bën asistimin në punën e Mjekut në Ordinanca Stomatologjike në kuadrin e Sektorit të Shëndetit Oral,
- bashkëpunon me Mjekun në promovimin e shëndetit oral, në kuadrin e Sektorit të Shëndetit Oral,
- kujdeset për pastrimin dhe sterilizimin e instrumenteve,
- asiston gjatë punës së Stomatologut,
- kryen edhe punët tjera sipas urdhërit të Shefit të sektorit të Shëndetit Oral,
- për punën e vetë i përgjigjet Kryeinfermierit dhe Shefit të sektorit të Shëndetit Oral,

### IV-Teknik/e laborant/e mjekësor/e- një pozitë

**Koeficienti : 5.40**

**Orari i punës: 40 orë në javë**

**Periudhë provuese 6 muaj**

Kushtet profesionale :

- a) përgatitja e mesme
- b) profesioni- Teknik Laborant mjekësor, biologji, kimi

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Punon analizat Laboratorike në lëmin e hematologjisë dhe biokimisë,
- bën pregaditjen për sterilizimin e instrumenteve të nevojshme laboratorike për marrjen e materialit laboratorik nga pacientët,
- kryen sterilizimin e mjeteve laboratorike,
- bën regjistrimin, klasifikimin, pagesat dhe shpërndarjen e rezultateve laboratorike,
- sipas udhëzimit mjekësor nga mjekët specialistë merr material edhe në shtëpi të pacientëve.
- kujdeset për përdorimin e inventarit dhe paisjeve mjekësore në mënyrë të rregullt dhe përgjigjet për gjendjen e tyre,
- regjistron materialin e marrë në formular,
- mbanë në mënyrë të rregullt dokumentacionin mjekësor,
- merr pjesë në aktivitetet e EVP në mënyrë që të freskojë dhe avancojë njohuritë dhe standardet e punës së laborantit,
- kryen edhe punët tjera të Laboratorit sipas urdhërit të shefit të sektorit të Diagnostikës dhe Laborantit Përgjegjës,
- për punën e vetë i përgjigjet Laborantit Përgjegjës të njësisë së Laboratorit.



## V-Shtëpiak-një pozitë

Koeficienti : 5.40

Orari i punës: 40 orë në javë

Periudhë provuese 6 muaj

Kushtet profesionale :

- a) Përgatitja e mesme,
- b) Drejtimi teknik,

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Organizon punën në kuadër të shërbimit teknik,
- Është përgjegjës për kualitetin e punës dhe ndërmerr masa adekuate për përmirësimin e tyre në shërbimin teknik,
- kujdeset për mirëmbajtjen efektive të objekteve (ujësjellës, kanalizim, elektrikë, axhustatori etj.),
- kujdeset për mirëmbajtjen e kopshtit,
- kujdeset për funksionim të rregullt të nxemjes qendrore në QKMF, QMF dhe AMF,
- kryen punën e vetë profesionale gjatë orarit të punës,
- përpilon raportet periodike dhe raporton për të njejt,
- është përgjegjës për mirëmbajtjen e aparaturës kundër zjarrit dhe bombolave të oksigjenit,
- bën kërkesën për furnizim me material hargjues,
- kryen edhe punët tjera sipas urdhërit të Shefit të Sektorit të Administratës,
- për punën e vetë i përgjigjet Shefit të Sektorit të Administratës.

Të gjithë të interesuarit për konkurim janë të obliguar të sjellin dokumentacionin e kërkuar dhe valid: 1.Kërkesën-, 2.Licencën e punës, 3.Dokumentin e identifikimit, 4. Diplomën e shkollimit, 5. Vërtetimin nga Gjykata që dëshmon që nuk ka ndonjë procedurë hetimore, 6. Certifikata e gjendjes shëndetësore.

**Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.**

Kërkesa për konkurim mirret dhe dorëzohet në zyrën pritëse K.K.Obiliq; për DSHMS-Obiliq.

Vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit do të thirren në testim.

Dokumentet e pa kompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

UD.Drejtori i DSHMS

Dr. Ibush MJEKIQI

